

Pyetjet e pranuarra përmes e-mail-it dhe përgjigjet e tyre

| Nr. | Pyetja | Përgjigja |
|-----|--|--|
| 1. | A mund te aplikojn Kompanit private SHPK apo vetem OJQ-et | - Vetëm Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ). (shih faqe 5, tek Udhëzuesi për aplikim). |
| 2. | Jam përfaqësues i një organizate joqeveritare nga Lugina e Preshevës dhe jemi të interesuar të aplikojmë në konkursin tuaj të fundit. Me këtë rast, dëshirojmë të kërkojmë nga ju informata shtesë lidhur me të drejtën e aplikimit, konkretisht nëse organizatat nga Lugina e Preshevës janë të pranueshme për këtë thirrje. | - Bazuar në kriteret e kualifikimit pranohen vetëm OJQ e regjistruara në Republikën e Kosovës. (shih faqe 6, tek Udhëzuesi për aplikim). |
| 3. | 5 % kontributi pensional per stafin e projektit, pra a pranohet te paraqitet kjo linje ne buxhet. | - Bazuar në shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme pagat e stafit paraqiten në shumën bruto. (shih faqe 16, tek Udhëzuesi për aplikim). |
| 4. | A eshte dokument obligativ: CERTIFIKATA NGA GJYKATA PER OJQ-N QE S'ESHTE NE PROCES TE FALIMENTIMIT, pasi ky dokument nuk kerkohet ne thirrjen publike, ndersa tek udhezuesi per aplikim, me saktesisht tek Kriteret e Kualifikimit dhe kërkesat specifike pika e 6 e kerkon nje gje te tille, nese mund te na sqaroni kete pike sepse nuk po eshte ne harmoni me thirrjen publike dhe po jem ne dilema ne kete pike. | - Certifikata nga Gjykata Komerciale që personi juridik nuk është në falimentim, kërkohet para nënshkrimit përfundimtar të kontratës. (shih faqe 18, tek Udhëzuesi për aplikim). |
| 5. | Per objektivin 1 "Inkurajimi i të rinjve dhe grave për ngritjen e kapaciteteve fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal", a mund te aplikojme per vetem nje target grup (psh te rinjte apo grate), apo duhet te targetohen te dyja grupet, pra edhe te rinjte edhe grate? | - Objektivi I fokusohet në të rinjtë dhe gratë si target grupe kryesore, megjithatë nuk është e detyrueshme të targetohen të dy grupet njëkohësisht. Projekti mund të fokusohet vetëm në njërin prej tyre (të rinjtë ose gratë), për sa kohë kjo zgjedhje arsyetohet qartë në projekt. |
| 6. | A mund te targetohen te rinjte ne menyre jodirekte, pra duke perdorur qasje sistemike, psh. duke trajnuar arsimtaret ne rolin e trajnerin per nje fushe te caktuar, e arsimtaret t'i trajnojne te rinjte? | - Aktivitetet, si trajnimet, duhet të organizohen nga vet OJQ-ja si subjekt juridik i regjistruar. Individët brenda OJQ-së mund të jenë trajnerë ose zbatues, por gjithmonë në emër dhe për llogari të OJQ-së, jo si persona privatë jashtë strukturës së saj. |
| 7. | Në thirrje ceket që një projekt ide për nderrmarësit e ri do të mbështeten me shumën deri 50% (deri 2000 €) nga MZHR dhe pjesa tjetër duhet të mbulohet nga OJQ; kjo shumë a vlen sikur nëngrant për bizneset | - OJQ-ja është përfituese e grantit dhe e përdor atë për zbatimin e mbështetjes financiare të startup-eve, në përputhje me rregullat e thirrjes. |

| | | |
|-----|---|--|
| | përfituese? a. Nëse jo, si është menduar kjo pjesë? | |
| 8. | Meqenëse bashkëfinancimi është i detyrueshëm për Objektivin III, a nënkupton kjo që buxheti total i projektit duhet të jetë 40000 - 60000 € si kombinim i kontributit të MZHR dhe palëve të tjera, apo MZHR mund të japë vetë deri në 60000 € duke ia dhënë projektit vlerë totale prej rreth 120000 €. | - Vlerat e planifikuara nga MZHR për mbështetjen e Objektivit III janë 40,000.00 € (shuma minimale) deri në 60,000.00 € (shuma maksimale). |
| 9. | A mund të ketë bashkëfinancim vetëm nga ana e OJQ që aplikon apo mund të ketë edhe palë të tjera që mund ta kompletojnë 50% të mbetur nga MZHR. a. Nëse po, me cilat palë preferohet të jet bashkëpunimi? | - Kjo objektivë aplikohet nga Organizatat të cilat mund të bashkë financojnë projektet e kësaj objektive dhe kanë bashkëfinancim të siguruar ose nga mjetet e veta ose nga burime te tjera si p.sh. donatorë, komuna, etj. |
| 10. | Kontributet nga ana jonë apo e partnerit a mund të jenë in-kind (kontribut në natyrë)? | - Kontributet in-kind (kontribut në natyrë) nuk janë të pranueshme. Ato duhet të jenë vetëm kontribute financiare. |